



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1459/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINE- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ-komercial sipas padisë së paditësit, M.... shpk me seli në zonën industriale Prishtinë e përfaqësuar nga avokatura SCLR Partners shpk nga Prishtina kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, vlersim doganor, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.979/20 të datës 27.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.979/2020 datës 27.05.2022, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.... shpk me seli në zonën industriale Prishtinë, është anuluar Aktvendimi nr.06.2/225/2017 dt.03.04.2020 i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe është obliguar e paditura që paditësit t,ia kthej shumën prej 6,659.24€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve importuese doganore për mallin e importuar përmes Deklaratës Doganore R-.... dt.15.03.2017 dhe R-.... dt.22.03.2017 ZBD I....

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ushtron e paditura, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të priset aktgjykimi A.nr.979/20 dt.27.05.2022 si i pabazuar në ligj, ta refuzon padin dhe kërkespadin e paditësit në tërsi si të pabazuar në ligj, ose t,ia kthej gjyaktës në rivendosje. Aktgjykimi në fjalë përmban shkelje të dispozitave materiale kur ka aprovuar kërkespadin e paditësit bazuar në nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave përkatësisht nenin 123 pa.1 pika (a) të Udhëzimit Administrativ 11/2009. E paditura në vendimin e saj ka konsideruar se paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të mjaftueshëm për faktin se paditësi nuk kishte prezantuar deklaratën eksportuese, ndersa gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike. E paditura nuk mund të pajtohet me konstatimet e gjykatës së shkallës së parë për shkak se e paditura në aktvendimin e kontestuar i ka dhënë sqarimet e nevojshme mbi bazën e të cilave ka ardhur deri tek rivlerësimi i mallit përkatësisht aplikimi i nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Në bazë të analizimit të DUD-ave të deklaruar shihet se paditësi ka deklaruar mallin me çmim më të ulët .

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 i LPK-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë nr.06.2/225/2017 dt.03.04.2020, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë M.... shpk me seli në zonën industriale Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit R-.... dt.15.03.2017 dhe R-.... dt.22.03.2017 ZBD I..., si të pabazuar. Në arsyetim të vendimit administrativ theksohet se Zyra e pranimit qëndror ka vepruar drejt kur ka vlerësuar mallin bazuar në metodën e gjashtë të vlersimit, neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109 respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, zhdoganimeve të mëhershme dhe dosjes së vlerës, pasi që këto të dhëna janë marrë nga Sektori i Vlerës, vlersim ky i cili është bërë duke i shfrytëzuar informatat e marra nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë. Në procedurën e administrimit të provave,

dokumentacionet përcjellëse të mallit lëndor janë vlersuar si prova të pamjaftueshme pasi Dogana e Kosovës konstaton se subjekti ka deklaruar vlerat e mallit me vlerë më të ulët se sa vlera reale e mallit lëndor.

Paditësi M... shpk me seli në zonën industriale Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ-komercial në Gjykatë të shkallës së parë, e cila në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me dt.27.05.2022, dhe pas administrimit të provave për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, e anulon aktvendimin kontestues të organit të paditur, dhe e obligon të paditësit që të paguar shumën prej 6,659.24€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve importuese doganore për mallin e importuar përmes Deklaratës Doganore R-..../15.03.2017 dhe R-.... dt.22.03.2017 ZBD I... Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar aktgjykimin se organi i paditur as në rivendosje nuk ka përfillur rekomandimet e gjykatës, nuk i ka vërtetuar faktet esenciale, ka nxjerr konkluzion jo të drejtë në pikpamje të gjendjes faktike, dhe nuk ka zbatuar drejt dispozitat e legjislacionit doganor. Paditësi ka paraqit dokumentacionin e nevojshëm si faturat, dhe transaksionin bankar duke përshkruar edhe numrin e faturave për mallin lëndor i cili dëshmon çmimin e blerjes realisht të paguar e të cilat dokumente përputhen plotësisht në kuptim të vlerës së transaksionit në kuptim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Aplikimi i metodës së 6 të vlersimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-34 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, për arsye se para se të aplikohet metoda 6 e vlersimit duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor. Gjykata e shkallës së parë pranon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe të drejtë, pasi që provat e paraqitura nga paditësi janë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se Aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në

përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, Kolegji i Dhomës së Dytë, nuk i aprovoi, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, kjo për faktin se paditësi ka deklaruar mallin me çmim më të ultë dhe se Dogana e Kosovës ka disponuar me të dhëna të disponueshme me çmime më të larta se ai i deklaruar, këto pretendime ankimore Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë nuk i aprovoi, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë rast provat-të dhënat e disponueshme nga dosja e vlerës të prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative-komerciale. Ngase gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi në procedurën administrative tek e paditura, por edhe në këtë konflikt administrativ ka paraqitur dokumentacionin valid dhe të mjaftueshëm si provë për DUD-at me nr R-.... dt.15.03.2017 dhe R-.... dt.22.03.2017 ZBD I..., si faturat e mallit, transaksionin bankar, me të cilat dokumentacione dëshmohet se është paguar vlera e mallit të kontraktuar dhe të gjitha këto dokumentacionet rezultojnë të jenë të harmonizuara sa i përket vlerës së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109 dhe dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Prandaj, pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave ligjore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë pa bazuara dhe pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, Aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të

mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Ne ankes e paditura në asnjë rast nuk konteston dokumentacionin e prazantuar nga paditësi me të cilin dëshkohet se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën e transaksionit në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03.L-109.

Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1459/2022 datë 13.10.2022

gjyqtari,

Kryetari i Kolegjit-

Krenar Berisha